



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr.326/2019

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata Themelore ne Mitrovice - Departamenti i përgjithshëm Gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari Gëzim Ademi ne çështjen penale, ndaj te pandehurit Rr.Y nga ... me vendbanim fsh ... për shkak te veprës penale: Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-ës, sipas Aktakuzës se P.TH. ne Mitrovice PP.II.nr.1674/2018 te datës 04.03.2019, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt. 21.06.2019, ne mungese të PTH, në prezencë te të pandehurit ne te njëjtën dite, publikisht shpall ndërsa me datën 28.06.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: Rr.Y, nga i ati A., e ëma R., e gjinisë A., i lindur me ..., me numër personal ..., me vendbanim ne fsh ..., shqiptar, kosovar, ka te kryer shkollën e mesme teknike i martuar, baba i shtate fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike, me pare i padënuar, ndaj tij nuk ka te zhvilluar procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Nga data e papërcaktuar deri me datën 13.04.2018 ne oborrin e shtëpisë te tij ne fsh ..., komuna e ..., ne kundërshtim me dispozitat e nenit 4 dhe nenit 5 par. 1 te Ligjit për armët, ka pasur ne posedim pushkën e llojit "M48" ngjyre e zeze, me numër serik 53016, tri korniza për pushke automatike, dy fishekore pa plumba, municion ne sasi prej tridhjetë plumba për pushkën automatike, pesëdhjetë e nëntë plumba te kalibrit me te madhe, i afte për te kuptuar rëndësinë e veprës se tij, duke dëshiruar kryerjen e saj dhe i vetëdijshtëm për ndalimin e veprës se tij, andaj ka pasur ne posedim arme ne kundërshtim me Ligjin i cili ka te bej me armen fjalë,

Me këtë ka kryer veprën penale: **Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-ës.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,49,50,51,52,73, dhe 374 par.1 te KPRK-ës , e lidhur me nenin 450 dhe 463 te KPP-ës e:

GJYKON

ME DENIM ME BURGIM, ne kohëzgjatje prej 1(një) viti i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri ne kohëzgjatje prej 2(dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale.

Ne mbështetje te nenit 374 par.3 e lidhur me nenin 69 te KPRK-se, dhe nenit 282 par.2 nenpar.2.1 te KPP-se, te pandehurit i shqiptohet:

DENIM PLOTËSUES

Konfiskohet pushka e llojit "M48" ngjyre e zeze, me nr. serik 53016, 89 fishek te kalibrit 7.62, 6 copa gëzhoja te kalibrit 7.62, 5 karikator te automatikut pa fishek, një kuti metali me dy rrethatore për fishek, një kondakët pushke te drurit.

OBLIGOHET i pandehuri qe ti paguaj shpenzimeve procedurale dhe atë ne emër te ekspertizës mjeko ligjore shumen prej 20 (njëzet)euro, ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimin shumen prej 30 euro, te cilat shpenzime i pandehuri është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Për Kërkesën pasurore juridike te dëmtuarit udhëzohen ne kontest te rregull civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.I.nr.1674/2018 te datës 04.03.2018, kundër te pandehurit Rr.Y nga ... me vendbanim ne fsh ..., për shkak të veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtim fillestar me dt. 21.06.2019, ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: e ndjej veten fajtor për veprën penale qe me ngarkohet, dhe njëherit me vjen keq për rastin qe ka ndodhur, është hera e pare qe kam ra ne kundërshtim me ligjin dhe i premtoj gjykatës qe ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla apo te tjera penale, po ashtu ja bej me dije gjykatës se i kam kushtet e dobëta, jam mbajtës i familjes dhe e kam nënën e sëmure dhe unë nuk punoj askund, dhe jetoj vetëm me pensionin e pleqërisë se nënës.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori deklaroi: Ne bazë te nenit 248 par. 2 te KPRK-ës e jap mendimin tim lidhur me pranimin e fajësisë lidhur me te akuzuarin Rr.Y ne drejtim te veprës penale, vet pranimi i fajësisë është dëshmi qe kemi lidhur me këtë aktakuzë, si dhe nga foto dokumentacioni nga te cilat shihet qartë ku është e cekur pushka ku është gjetur si dhe plumbat e kalibrit 7,60 mm i propozoj gjykatës qe te pranohet pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit pasi qe i njëjti ishte ne mënyrë vullnetare, pa presion, me këtë gjykata duhet te këtë parasysh qe nga i njëjti janë marr 89 plumba kalibrit 7.62mm si dhe si rrethanë tjetër lehtësuese është edhe thënia nga KE ku shihet qartë se i njëjti deri me sot nuk ka kryer asnjë vepër tjetër penale deri me sot dhe kjo vlerësohet si rrethanë lehtësuese.

Vlerësimi i pranimit te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e Gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: Shkresat e policisë sipas nr. ..., procesverbalin mbi bastisjen e banesës dhe personave nga 13.04. 2018, raportin policor nr. ..., fotodokumentacionin me vërtetimin mbi sendet e sekuestruara nga i pandehuri ,ekstrakti nga dosja kriminale si dhe shkresat e tjera te lendes nga te gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Mbjajtja ne pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-ës.

Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me gjobë 7500 euro ose me burgim deri ne 5(pes) vite, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale, po ashtu si rrethane renduese gjykata mur faktin se i njëjti figuron ne evidencën e te kaluarës kriminale edhe për një rast tjetër penal. Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale. Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton dënimi me kusht, nga se do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet procedurale- paushallin gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave shumen prej 30 Euro te

gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450,463 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.326/2019 dt.28.06.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari :
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate.